


REPUBLIKE KOSOVË - REPUBLICA KOSOVARE		PUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dip.	2-D/DPK	Nr. Prot.
Dip.		B-Prot.
Dip.		prot NO
Nr. Eran		24.01.2014
çmimi/časina	02	Datum
Nr. papas		Duraxh



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupcionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupcionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupcionit me datë 22.01.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-3557/13 për ztr. Veton Nevzadi – Drejtor i Drejtorisë për Rini, Kulturë e Sport në Komunën e Gjilanit, për shkak se ështëshmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-3557-13, për Zyrtarin e lartë, z. Veton Nevzadi - Drejtor i Drejtorisë për Rini, Kulturë e Sport në Komunën e Gjilanit, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-3557/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Nevzadi së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupcionit (Z.D.DPK-01-3922-13), pas të cilës zyrtari është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Nevzadi në AKK ka dërguar një shkresë (DPK/DPKI-03-4084-13) në të cilën është deklaruar se paraprakisht, në mungesë të informacionit, këte nuk e ka konsideruar si situatë të konfliktit të interesit, por tanj kur është bindur për këtë, ka nisë procedurën për shmangje të kësaj situatë.

Meqense kishte kaluar kohë, jashtë afateve të dhëna ligjore, dhe zyrtari i lartë nuk i ka bërë veprimet e duhura për të shmangur këtë situatë, Agjencia kundër Korrupcionit, konform nenit 18

paragafi 5 i Ligjit Nr.04/L-051 për parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik i ka bërë edhe shkresën e dytë – Paralajmërimin (18.12.2013).

Ndërkohë, pas shkresës tonë të dytë, ztr. Nevzadi ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit dhe ka njoftuar se ai tashmë nuk është në funksionin e Drejtorisë për Rini, Kulturë e Sport në Komunën e Gjilanit, por po ashtu në AKK ka sjellur dokumentin zyrtar të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, në të cilin shihet se biznesi “Euro Shop-GJ” është shuar në mënyrë vullnetare.(DP.03-144/14).

II. Në pajtim me nenin 18 paragafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtoret të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencise kundër Korrupsionit

